

20242724691

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË BUXHETEVE

Neni 1

Në Ligjin e Buxheteve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 203/22, 58/23, 39/24 dhe 76/24) në nenin 2, në pikën 32, pas fjalës “infrastrukturë”, shtohen fjalët “të cilat gjatë investimit ose përdorimit operacional financohen ose bashkëfinancohen nga të ardhurat publike dhe hyrjet tjera, të ardhurat personale të subjekteve publike, mjetet e marra nga buxheti i Bashkimit European apo partnerë tjerë të zhvillimit, përfshirë dhe huamarrjet ose për të cilat do të kërkohet lëshimi i garancisë në pajtim me ligjin që rregullon borxhin publik”.

Neni 2

Në nenin 4, paragrafi (2) shlyhet:

Paragrafët (3), (4), (5) dhe (6) bëhen paragrafë (2), (3), (4) dhe (5).

Neni 3

Në nenin 8, paragrafi (6) ndryshohet si vijon:

“Në rast se rregullat apo aktet e propozuara kanë implikime në drejtim të promovimit të barazisë gjinore, krahas tyre duhet të dorëzohet edhe një deklaratë buxhetore e përgjegjshme gjinore, për të cilën Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë jep mendim”.

Në paragrafin (7) fjalët: “ministri i Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalët: “Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë”, ndërsa fjalët “deklaratë buxhetore në bazë gjinore” zëvendësohen me fjalët: “Deklaratë buxhetore me përgjegjësi gjinore”.

Neni 4

Në nenin 11, paragrafi (2), në pikën 5 fjalët “reforma strukturore dhe” shlyhen.

Neni 5

Në nenin 13, paragrafi (1) fjalët “15 dhjetor” zëvendësohen me fjalët “15 janar”, ndërsa fjalët: “strategjitë sektoriale” zëvendësohet me fjalët: “Strategjitë sektoriale dhe multisektoriale”.

Paragrafi (3) ndryshon si vijon:

“Shfrytëzuesit buxhetorë amë përpilojnë plan strategjik për aktivitetet dhe projektet në kuadër të kompetencave të tyre, të harmonizuara me prioritetet dhe qëllimet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Strategjinë Nacionale për Zhvillim, Programin e Punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Programi Nacional për miratimin e të drejtës së Bashkimit European, strategjitë sektoriale dhe multisektoriale”. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut përpilon plan strategjik për aktivitetet dhe projektet në kuadër të kompetencës së tij në pajtim me Ligjin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.”.

Paragrafi (5) ndryshon si vijon:

“Njësia organizative në kuadër të Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut përgjegjëse për koordinimin e procesit të planifikimit strategjik të shfrytëzuesve buxhetorë amë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, dorëzon udhëzime të detajuara dhe udhëzime për përgatitjen e planit strategjik, strategjitë sektoriale dhe shumësektoriale.”.

Pas paragrafit (5), shtohet paragrafi i ri (6), si vijon:

“(6) Prioritetet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe planet strategjike të shfrytëzuesve buxhetorë duhet të jenë të harmonizuara me strategjitë sektoriale dhe shumësektoriale, si dhe me Strategjinë Nacionale për Zhvillim, prioritetet dhe treguesit e së cilës duhet të jetë baza për përgatitjen e këtyre dokumenteve strategjike.”.

Neni 6

Në nenin 18, paragrafin (1), pas pikës 3 shtohet pika e re 3-a si vijon:

“3-a. Analizë dhe kontroll të shpenzimeve nga zbatimi i politikës së caktuar buxhetore;”.

Neni 7

Në nenin 20, në paragrafin (1) fjalët “të cilët i përgatisin në pajtim me metodologjinë e përcaktuar dhe i parashtrojnë në Ministrinë e Financave për kontroll dhe vlerësim” shlyhen.

Paragrafi (2) ndryshon si vijon:

“Shfrytëzuesit buxhetorë amë, përfshirë komunat, i paraqesin nismat e reja në formën e projekteve të investimeve publike, në emër të tyre, pra në emër të subjekteve publike nën kompetencën e tyre, pas një vlerësimi dhe evoluimi të kryer më parë nga Ministria e Financave, pra një grup pune/komision i formuar nga Këshilli i komunës dhe ka përcaktuar prioritetin e propozimit për projektet e investimeve publike nga një grup/komision ndërinstytucional i punës i formuar nga Qeveria, përkatësisht Këshilli i komunës.”.

Paragrafët (3) dhe (4) shlyhen.

Paragrafi (5) që bëhet paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

“(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht Këshilli i komunës vendos për listën prioritare përfundimtare të propozimprojekteve për investime publike.”.

Paragrafi (6) bëhet paragrafi (4).

Paragrafi (7) që bëhet paragrafi (5) ndryshohet si vijon:

(5) Mënyrën, përmbajtjen, procedurën dhe kriteret për përcaktimin, përgatitjen, shqyrtimin, vlerësimin, evaluimin, mënyrën e përcaktimit të propozimeve prioritare për projektet e investimeve publike, si dhe zbatimin, monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin dhe rishikimin ex-post të projekteve për investimet publike rregullohen më ngushtë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë së Financave.

Pas paragrafit (5), shtohen dy paragraf të rinj (6) dhe (7) si vijojnë:

“(6) Subjektet publike që nuk janë shfrytëzues buxhetorë, përveç Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë përgatitjes së programeve të tyre të punës (programeve investuese), përzgjedhin projektet e investimeve publike nga lista prioritare përfundimtare e propozimit për projekte për investime publike nga paragrafi (3) i këtij neni.

(7) Subjektet publike nga paragrafi (6) i këtij neni, raportet tremujore ia dorëzojnë Ministrisë së Financave për monitorim të realizimit të projekteve për investime publike.”.

Neni 8

Në nenin 22, paragrafi (3) shlyhet:

Neni 9

Në nenin 31, paragrafi (2), në pikën 2 nënpika gj) ndryshohet si vijon:

“treguesit gjinorë dhe deklarata buxhetore e përgjegjshme gjinore kur identifikohet të paktën një objektiv gjinor aty ku është e mundur;”.

Neni 10

Në nenin 32, paragrafi (2), në pikën 3, në fund të fjalisë pika zëvendësohet me lidhëzën “dhe”.

Pas pikës 3 shtohet pikë e re 4 si vijon:

“4. miratimin e propozimit të planit financiar të ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare të themeluara nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe të njëjtin ia dorëzon Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.”.

Neni 11

Pas nenit 33, shtohet neni i ri 33-a si vijon:

„Neni 33 – a

Paraqitja e propozimplaneve financiare të ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare të themeluara nga Republika e Maqedonisë së Veriut

(1) Ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare të themeluara nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe shoqëritë tregtare të themeluara prej tyre përgatisin propozimplan financiar, i cili përmban:

- realizimin e hyrje-daljeve për vitin paraprak, vlerësimin e realizimit të hyrje-daljeve për vitin aktual, hyrje-daljet e planifikuara për pesë vitet e ardhshme;
- arsyetimin e propozimit të planit financiar;
- përkrahimin dhe kompetencat e ndërmarrjes publike dhe shoqërisë tregtare shtetërore;
- arsyetimin për qëllimet dhe aktivitetet e përcaktuara në përputhje me strategjitë dhe dokumentet e zhvillimit afatgjatë;
- bazën ligjore dhe të tjera për daljet e planifikuara;
- burimet e financimit;
- rishikimin mujor të të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara për vitin e ardhshëm;
- rishikimin mujor të hyrjeve dhe daljeve të planifikuara për vitin e ardhshëm;
- Bilancin e gjendjes dhe Bilancin e suksesit për vitin pasardhës;
- rishikimin mujor të plotësimeve dhe vendeve të lira të planifikuara për vitin e ardhshëm dhe
- informacionet e tjera të nevojshme.

(2) Udhëheqësi i ndërmarrjes publike dhe i shoqërisë tregtare të themeluar nga Republika e Maqedonisë së Veriut është përgjegjës për:

- përgatitjen dhe dërgimin e propozimit të planit financiar tek përdoruesi amë buxhetor;
- dorëzimin e raporteve, tremujore, raporteve vjetore financiare dhe të dhënave të tjera financiare në Ministrinë e Financave;
- dorëzimin e planit financiar të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Ministrinë e Financave dhe
- dorëzimin e raporteve gjashtëmujore dhe vjetore për zbatimin e planit financiar te shfrytëzuesi amë buxhetor.

(3) Udhëheqësi i shoqërisë tregtare të themeluar nga Republika e Maqedonisë së Veriut, propozimin e planit financiar ia dorëzon shfrytëzuesit amë buxhetor, së bashku me planet e propozuara financiare të shoqërive tregtare, themelues i të cilave është.

4) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut jep pëlqimin për planin financiar nga paragrafi (1) i këtij neni, me propozim të udhëheqësit të shfrytëzuesit buxhetor amë, përveç nëse me ligj tjetër nuk është rregulluar.

(5) Afatet për përgatitjen, dorëzimin dhe miratimin e planit financiar nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohen në planin me afate nga neni 28 paragrafi (2) i këtij ligji.”.

Neni 12

Në nenin 35, paragrafi (2), në pikën 5 pas fjalës “gjinia” shtohet fjala “përgjegjës”.

Neni 13

Në nenin 67, në paragrafin (2), pas fjalëve “Republika e Maqedonisë së Veriut” shtohen fjalët: “dhe shoqëritë tregtare të themeluara prej tyre”.

Në paragrafin (6) fjalët “Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës” zëvendësohen me fjalët “Ministria e Administratës Publike”.

Paragrafi (7) shlyhet.

Paragrafi (8) bëhet paragraf (7).

Neni 14

Në nenin 69, pas paragrafit (6) shtohen tre paragrafë të rinj (7), (8) dhe (9), si vijojnë:

“(7) Për mjetet në valutë të shfrytëzuesve buxhetorë, ata hapin llogari në valutë në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut pas pëlqimit paraprak të Ministrisë së Financave.

(8) Pas hapjes së llogarive në valutë nga paragrafi (7) i këtij neni, shfrytëzuesit buxhetorë hapin llogari korrespondente në kuadër të ETS.

(9) Ministri i Financave përcakton mënyrën e hapjes së llogarive në valutë të shfrytëzuesve buxhetorë.”.

Neni 15

Në nenin 76, në paragrafin (4) fjalët: “Ministria e Ekonomisë” zëvendësohet me fjalët: “Ministria e Energjetikës, Minierave dhe Burimeve Minerale”.

Në paragrafin (5) fjalët: “Ministria e Ekonomisë” zëvendësohet me fjalët: “Ministria e Energjetikës, Minierave dhe Burimeve Minerale”.

Neni 16

Neni 79 shlyhet.

Neni 17

Në nenin 83, paragrafi (3) fjalët “Ministria e Ekonomisë” zëvendësohen me fjalët: “Ministria e Ekonomisë dhe e Punës”.

Neni 18

Në nenin 91, paragrafi (4) shlyhet.

Neni 19

Në nenin 92, paragrafi (4) shlyhet.

Neni 20

Në nenin 93, në paragrafin (5) fjalët: “treguesit e përgjegjshëm gjinorë” zëvendësohen me fjalët: “tregues gjinorë”.

Neni 21

Në nenin 94, në paragrafin (3) fjalët: “30 prill” zëvendësohen me fjalët: “31 maj”.

Paragrafi (8) ndryshohet si vijon:

“Kryetari përgatit Propozimllogarinë përfundimtare të buxhetit të komunës dhe ia paraqet Këshillit të komunës jo më vonë se data 31 mars e vitit aktual”.

Paragrafi (9) ndryshohet si vijon:

“Këshilli i komunës miraton Propozimllogarinë përfundimtare të buxhetit të komunës jo më vonë se 30 prilli i vitit aktual”.

Neni 22

Në nenin 96, paragrafi (1) në pikën 4 fjalët: “iniciativa buxhetore gjinore” zëvendësohen me fjalët: “deklarata e buxhetit e përgjegjshme gjinore”.

Neni 23

Në nenin 111, pika 5 ndryshohet si vijon:

“nuk vepron në pajtim me nenin 94, paragrafët (8), (10) dhe (11) të këtij ligji;”.

Neni 24

Neni 112 ndryshohet si vijon:

“Gjobë në shumë prej 400 deri në 500 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në ndërmarrje publike, subjekt tjetër publik apo person tjetër juridik nëse nuk i publikon në ueb faqen e saj raportet financiare vjetore dhe deklaratat, në pajtim me nenin 95 paragrafi (2) të këtij ligji.”.

Neni 25

Në nenin 122, fjalët “1 janar 2025” zëvendësohen me fjalët “1 janar 2026”.

Neni 26

Dispozitat e neneve 4, 8, 12, 15 dhe 20 të Ligjit të Buxheteve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 203/22, 58/23, 39/24 dhe 76/24) do të fillojnë të zbatohet nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ndalohet të jenë të vlefshme dispozitat e nenit 26 të Ligjit të Buxheteve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 64/05, 4/08, 103/08, 156/09, 95/10, 180/11, 171/12, 192/15, 167/16 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 151/21).

Aktet nënligjore të parapara me Ligjin e Buxheteve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 203/22, 58/23, 39/24 dhe 76/24) do të miratohen në afat prej 12 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 27

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.